



QKLL 2025

AKTIVITETE TË QENDRËS KOMBËTARE TË LIBRIT DHE LEXIMIT

ALDA BARDHYLI – DREJTORE E QKLL

PËRGATITI: DR. ANILA VOGLI MAKRI

QERSHOR



21-22 QERSHOR 2025 / PANAIRI I PARË I LIBRIT SHQIP NË PRESHEVË “PRESHEVA FLET”



11-15 QERSHOR 2025 / U ÇEL EDICIONI I 25-TË I PANAIRIT MBARËKOMBËTAR TË LIBRIT “PRISHTINA 2025”



19 QERSHOR 2025 / Në ekspozitën “KUJTESA E MESDHEUT – NGA ANTIKITETI NË KOHËT MODERNE”, në Bibliotekën Kombëtare



5 qershor 2025 / Takim me fituesit në vite të FONDIT TË KRIJIMTARISË LETRARE PËR FËMIJË PËR VITIN 2025



6-7 qershor 2025 / PANAIRI I LIBRIT - Mbajtur në qytetin e Shkodrës



14 qershor 2025 / Një mbrëmje mes vargësh dhe reflektimesh mbi forcën e librit, nën kurimin e Valentina Hysit



13 qershor 2025 / Shpallen 3 veprat fituese të FONDIT TË KRIJIMTARISË LETRARE PËR FËMIJË PËR VITIN 2025



26 qershor 2025 / Takim letrar: i ftuar shkrimtari për fëmijë - XHAVIT SYLA





QKLL 2025

AKTIVITETE TË QENDRËS KOMBËTARE TË LIBRIT DHE LEXIMIT

QERSHOR



21-22 QERSHOR 2025 / PANAIRI I PARË I LIBRIT SHQIP NË PRESHEVË “PRESHEVA FLET”



Në hapjen e Panairit të Parë të Librit Shqip në Preshevë, fjala e ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit – zotit Blendi Goxhe:

Në Preshevë, në një takim të përzemërt me kryetaren e Komunës, znj. Ardita Sinani, dhe ambasadorin e Shqipërisë në Serbi, z. Bardhyl Canaj, në kuadër të Panairit të Parë të Librit Shqip.

Një organizim i veçantë për të sjellë gjuhën shqipe kudo ku ka shqiptarë, si një pasuri të madhe të përbashkët, për të cilën kemi detyrë ta ruajmë, ta kultivojmë dhe ta përcjellim ndër breza.

Gjithashtu, me shumë kënaqësi iu përgjigja ftesës së Kryetares Sinani për spektaklin “Shën Tereza,

shqiptarja e gjithë botës”, për misionaren e madhe Shqiptare.

Si Ministër i Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, e konsideroj një nder dhe përgjegjësi të veçantë të jem i pari ministër përgjegjës për kulturën që viziton Preshevën, një vend ku ndjenja e përkatësisë kombëtare është e gjallë dhe e palëkundur, dhe ku respekti për gjuhën dhe kulturën shqiptare jetohet me dashuri e përkushtim, çka motivon e frymëzon më shumë mbështetje.

Privilegj e kënaqësi, nder e krenari të jesh në Preshevë si ministër i Qeverisë Shqiptare, me porosinë e veçantë dhe vëmendjen e Kryeministrit Edi Rama, në tokën ku kultura shqiptare jetohet me

kaq dashuri e përkushtim, çka na frymëzon e na motivon të jemi edhe më pranë e të bëjmë edhe më shumë për sfidat që na bashkojnë! Faleminderit Kryetares së Komunës Ardita Sinani dhe gjithë komunitetit të Luginës së Preshevës për mikpritjen e ngrohtë në Panairin e parë ndonjëherë të Librit Shqip në Preshevë!

Së shpejti, si MEKI, do të lidhim një marrëveshje bashkëpunimi enkas për Preshevën, që do të mundësojë projekte e programe shkëmbimi profesionale, ture e eksperiencia krijuese, mbështetje teknike e promovim traditash, arti, kulture e trashëgimie.



QKLL 2025

AKTIVITETE TË QENDRËS KOMBËTARE TË LIBRIT DHE LEXIMIT

QERSHOR



19 QERSHOR 2025 / NË EKSPOZITËN “KUJTESA E MESDHEUT – NGA ANTIKITETI NË KOHËT MODERNE”, NË BIBLIOTEKËN KOMBËTARE

Në ekspozitën “Kujtesa e Mesdheut – nga Antikiteti në Kohët moderne”, një udhëtim mbresëlënës nëpër fondin e pasur të Bibliotekës Kombëtare, ku u sollën në vëmendje mbi 700 vepra të rralla nga shekulli XIV deri në XIX – libra, dorëshkrime, harta e gravura.

Kjo ekspozitë, me ndarjen e saj tematike të kujdesshme dhe thellësinë kulturore që ofron, është një kontribut i vyer në ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë sonë dokumentare. Një ftesë për të reflektuar mbi vendin e Shqipërisë në historinë e Mesdheut dhe për të rigjetur lidhjet tona me Lindjen, Perëndimin dhe vetveten.





QKLL 2025

QERSHOR



AKTIVITETE TË QENDRËS KOMBËTARE TË LIBRIT DHE LEXIMIT

11-15 QERSHOR 2025 / U ÇEL EDICIONI I 25-TË I PANAIRIT MBARËKOMBËTAR TË LIBRIT “PRISHTINA 2025”

Me moton “Inteligjenca rrjedh nga libri” çeli siparin edicioni i 25-të i Panairit mbarëkombëtar të librit “Prishtina 2025” nën praninë e personaliteteve të fushës së librit dhe të kulturës.

Panairi ishte i hapur për vizitorët çdo ditë nga data 11 deri më 15 qershor.

Në këtë ngjarje morën pjesë rreth 100 botues nga Kosova, Shqipëria, Maqedonia e Veriut dhe diaspora. Hapjen e panairit e përshëndeti drejtoresha e Qendrës Kombëtare të Librit dhe Leximit, Alda Bardhyli.

“Në një kohë kur informacioni është kudo, por e vërteta shpesh është e megjulluar, libri mbetet busulla që na ndihmon të gjejmë drejtimin e duhur në rrugën tonë

intelektuale dhe shpirtërore. Panairi i këtij viti është dëshmi se, edhe pas një çerek shekulli, interesi për librin nuk ka mbaruar – përkundrazi, ai po rilind me forma të reja, me autorë të rinj, me lexues gjithnjë më të etur për dije. Ta shfrytëzojmë këtë ngjarje për të thelluar dialogun tonë kulturor, për të forcuar lidhjen mes brezave nëpërmjet librave dhe për të krijuar ura mes kulturave përmes fjalës së shkruar. Nëse vërtet besojmë se e ardhmja ndërtohet mbi dije dhe mendim të lirë, atëherë sot e kemi një mision të përbashkët: ta mbrojmë librin, ta promovojmë leximin dhe ta shndërrojmë çdo shtëpi, shkollë, bibliotekë e shesh publik në hapësirë të dijes dhe mendimit”, u

shpreh ndër të tjera drejtoresha e Qendrës Kombëtare të Librit dhe Leximit, Alda Bardhyli.

Me mbi 40 aktivitete ky panair përkon me përvjetorë të rëndësishëm që u shoqëruan me aktivitete, përkujtime, debate dhe promovime, ku pati të ftuar specialë, shkrimtarë nga vende të Europës etj.

Përvjetorët që u shënohen në Panairin e 25-të të librit ishin:

- 100-vjetori i lindjes së Martin Camajt
- 150-vjetori i lindjes së Faik Konicës
- 200-vjetori i lindjes së Pashko Vasës
- 400-vjetori i lindjes së Pjetër Bogdanit.



12 QERSHOR 2025 / Një vizitë në bibliotekën “HIVZI SULEJMANI” TË PRISHTINËS

E shoqëruar nga Sibel Halimi, drejtoreshë e Drejtorisë së Kulturës të Prishtinës dhe drejtoresha e Bibliotekës Naime Beqirajaj, drejtoresha e QKLL, Alda Bardhyli, u njoh me punën, fondin e librave

në bibliotekën në qendër dhe në degët e saj në pjesë të tjera të kryeqytetit dhe në fshatrat e komunës së Prishtinës. Të tri drejtoreshat u dakorduan për thellimin e bashkëpunimit në mes

të tri institucioneve kulturore, letrare dhe artistike, për këmbimin e librave, përvojave, ngjarjeve dhe autorëve.



QKLL 2025

QERSHOR



AKTIVITETE TË QENDRËS KOMBËTARE TË LIBRIT DHE LEXIMIT



1 QERSHOR 2025 / TAKIM ME SHKRIMTARË TË LETËRSISË PËR FËMIJË NË DITËN E 1 QERSHORIT


Gëzuar 1 Qershorin, festën e bukur të fëmijëve!

Le t'i rrisim ata me dashurinë për dijen dhe leximin, për t'ia bërë më të lehtë rrugën e gjatë të jetës.

Mbështetja e librit për fëmijë, e autorëve që shkruajnë letërsi për fëmijë është pjesë e politikave tona për të nxitur leximin, ruajtur traditën dhe pasurimin e

bibliotekave me më shumë letërsi shqipe.

Nderim për gjithë krijuesit e letërsisë për fëmijë.



5 QERSHOR 2025 / Takim me fituesit në vite të FONDIT TË KRIJIMTARISË LETRARE PËR FËMIJË PËR VITIN 2025

"Libri të ban të lirë" ishte tema e Panairit të parë të librit që u mbajt në qytetin e Shkodrës. Në këtë panair morën pjesë disa shtëpi botuese, të cilat prezantuan për lexuesin shkodran titujt e tyre të rinj në kategorinë e librave

artistikë për të rritur, fëmijë dhe librit studimor. Programi i këtij panairi ishte i pasur me aktivitete për librin, promovimin e titujve të rinj si dhe lexime nga autorët. Ndër autorët pjesëmarrës ishin: Stefan Çapaliku,

Artur Baku, Andreas Dushi, Suad Arilla, Durim Taçi, Ledia Dushi, Liridon Mulaj, Arjola Zadrime, Lekë Tasi, Xhahid Bushati, Ndue Ukaj dhe Mark Lucgjonaj. Panairi qëndroi i hapur deri më datë 7 qershor 2025.



QKLL 2025

QERSHOR



AKTIVITETE TË QENDRËS KOMBËTARE TË LIBRIT DHE LEXIMIT



U mbajt në mjediset e Qendrës Kombëtare të Librit dhe Leximit një diskutim i frytshëm mbi letërsinë për fëmijë.

Ky takim që bëri bashkë shkrimtarë të letërsisë për fëmijë erdhi pas hapjes së thirrjes së Fondit të Krijimtarisë Letrare për Fëmijë për vitin 2025, një fond i përvitshëm që mbështetet nga QKLL.

Pjesë e tryezës së diskutimit ishin fitues të këtij fondi ndër vite si: Zimo Krutaj, Rudina Çupi, Riza Braholli, si dhe shkrimtarë të tjerë të afirmuar të letërsisë për fëmijë si Edi Gogu, Lefteri Gjoshe, Rajmonda Belli, Majlinda Leka etj., të cilët ndanë me të pranishmit sfidat e kësaj letërsie si një letërsi e domosdoshme në rritjen dhe edukimin e brezave që vijnë.

10 QERSHOR 2025 / ME AUTORIN ALBAN BALA PËR PREZANTIMIN E LIBRIT TË TIJ “PUTHLUTJA IME”

U promovua në mjediset e Qendrës Kombëtare të Librit dhe Leximit nën shoqërinë e kritikut Agim Baçi, libri më i ri me poezi nga Alban Bala me titull: “Puthlutja ime”. Një vëllim interesant me përjetimet

personale të autorit mbi temën e dashurisë, jetës, ekzistencës dhe Zotit.
*Të pashë vajzuke, dritë,
veshur në të bardha,
zbrisje shkallët prej guri të kujtesës.*

*Të prita sa me të thanë ‘më ka marrë malli’
ti heshte gjer tani dhe unë u zbardha.*
Shkëputur nga poezia “Në oborrin e Rushës”.



13 QERSHOR 2025 / SHPALLEN 3 VEPRAT FITUESE TË FONDIT TË KRIJIMTARISË LETRARE PËR FËMIJË PËR VITIN 2025

Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit ndau vlerësimet për fituesit e Fondit të Krijimtarisë Letrare për Fëmijë për vitin 2025.

Juria, e kryesuar nga Dr. Albert Gjoka dhe me anëtarë Irena Prici dhe Flori Kasaj vlerësuan mes 19 dorëshkrimeve këto tri vepra fituese:

“Enigma e Kësulës së Kuqe”, me autor Ermir Nika, - me motivacionin: “Për një lojë intertekstuale postmoderne të përrallës së Kësulkuqes që vjen e dekonstruktuar natyrshëm dhe që nxit më tej kureshtjen dhe imagjinatën e lexuesve të vegjël përmes një rrëfimi të zhdërvjellët dhe domethënës”.



QKLL 2025

QERSHOR



AKTIVITETE TË QENDRËS KOMBËTARE TË LIBRIT DHE LEXIMIT

“Iliri dhe Lepurushi zbulojnë kopshtin zoologjik magjik”, me autore Flogerta Krypi, me motivacionin: “Për sendërtimin e një përralle edukative që kultivon raporte të gjalla mes fëmijëve dhe botës së kafshëve, për vlerat didaktike në formësimin psikologjik dhe emocional të fëmijëve, që vijnë natyrshëm përmes të gjithë elementeve që përmban libri”.
“Dhjetë pyetjet e Ardenit që pritin përgjigje”, me autore Raimonda Belli Gjençaj, me motivacionin: “Për

gjetjen tematike, që provokon botën e fëmijëve sot, për një regjistër të hollë humori në rrëfim dhe për jetësimin e vlerave të librit dhe dijes njerëzore tek fëmijët”.

Fondi i Krijimtarisë Letrare për Fëmijë çdo vit, u jep mundësinë 3 autorëve të letërsisë për fëmijë të botojnë veprat e tyre.



14 QERSHOR 2025 / “NGA LIBRI NË SKENË DHE EKRAN, NGA SKENA DHE EKRANI... NË LIBËR” – Një mbrëmje mes vargjesh dhe reflektimesh mbi forcën e librit, nën kurimin e **VALENTINA HYSIT**

“Nga libri në skenë dhe ekran, nga skena dhe ekran... në libër” – Një mbrëmje mes vargjesh dhe reflektimesh mbi forcën e librit, nën kurimin e Valentina Hysit, projekt i mbështetur nga Ministria e Ekomomisë, Kulturës dhe Inovacionit, solli emocione për të pranishmit.

Në këtë aktivitet morën pjesë artdashës, dashamirës të librit, skenës e ekranit, autorë e botues. Gjatë mbrëmjes letrare u sollën fragmente nga perlat e lirikës

shqiptare dhe të huaj, si: Ndre Mjeda, Ali Asllani, Faik Konica, Lasgush Poradeci, Petro Marko, Jakov Xoxa, Ismail Kadare, Dritëro Agolli, Xhevahir Spahiu etj., apo autorëve të huaj si Whitman, Kipling, nëpërmjet interpretimit emocionues të aktorëve Sokol Angjeli dhe Elva Çausi shoqëruar edhe me ilustrime filmike.

Ndërsa, drejtoresha e Qendrës Kombëtare të Librit dhe Leximit, Alda Bardhyli dhe studiuesi Ben Andoni, ndanë me të pranishmit

pikëpamjet e tyre mbi letërsinë e sotme, lidhjen e lexuesit me librin, politikat që duhen ndjekur me qëllim që të ngjallet dashuria për librin dhe leximin.

Për realizimin e këtij aktiviteti, që ndërthuri tri fusha si libër-skenë-ekran dhanë kontributin e tyre edhe regjisori i njohur, Ylli Pepo si dhe operatori Xhemal Reçi.





QKLL 2025

AKTIVITETE TË QENDRËS KOMBËTARE TË LIBRIT DHE LEXIMIT

QERSHOR



17 QERSHOR 2025 / TAKIMIN LETRAR NË BASHKINË ROSKOVEC ME PJESËMARRJEN E SHKRIMTARËVE PRIMO SHLLAKU DHE AGRON GOGO

Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit në bashkëpunim me bashkinë Roskovec, organizuan në hollin e bashkisë Roskovec, takimin letrar me pjesëmarrjen e shkrimtarëve Primo Shllaku dhe Agron Gogo. Qytetarë dhe lexues të shumtë shkëmbyen pyetje-përgjigje mbi krijimtarinë letrare të z. Shllaku, i cili shprehu kënaqësinë dhe befasinë për ambientin e ngrohtë në Roskovec. Agron Gogo si shkrimtar, por edhe bir i Roskovecit përtej të tjerave

theksoi se kritika letrare është ajo çka e evidenton talentin e shkrimtarit. Sipas tij, nuk ka rëndësi se ku jeton dhe krijon shkrimtari duke evidentuar faktin se nga Roskoveci apo çdo skaj i Shqipërisë, letërsia e mirë do ta gjejë vendin e saj. Aktivitetin e përshëndeti kryetarja e bashkisë, znj. Majlinda Bufi si dhe shkrimtari Flamur Çepele. Ky takim u mbajt në kuadrin e nismës "Letërsia dhe kufijtë", e cila do të shtrihet në disa qyteza të

Shqipërisë duke bërë bashkë krijues dhe lexues nga çdo hapësirë e Shqipërisë.



18 QERSHOR 2025 / TAKIM NË GRAMSH ME SHKRIMTARIN DHE PUBLICISTIN BEN BLUSHI

Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit në bashkëpunim me bashkinë e qytetit të Gramshit, mbajti takimin e radhës të ciklit "Letërsia dhe kufijtë" ku i ftuar ishte shkrimtari dhe publicisti Ben Blushi. Në një bisedë mbresëlënëse dhe plot kureshtje mes të pranishmëve dhe zotit Blushi, u diskutuan tema dhe çështje të ndryshme që nga Inteligjenca Artificiale, përfitimet që sjell ajo e deri tek provincat si hapësira të

pandryshuara, të cilat kanë ruajtur natyralitetin shoqëror. Takimin e përshëndetën kryetari i bashkisë së Gramshit z. Besian Ajazi dhe poetja Leidi Shqiponja. Cikli i takimeve "Letërsia dhe kufijtë" ka si synim të gjallërojë jetën letrare në qytezat e Shqipërisë me qëllim shkëmbimet kulturore, kryesisht me fokus librin dhe letërsinë.





QKLL 2025

QERSHOR



AKTIVITETE TË QENDRËS KOMBËTARE TË LIBRIT DHE LEXIMIT



26 QERSHOR 2025 / TAKIM LETRAR: I FTUAR SHKRIMTARI PËR FËMIJË - XHAVIT SYLA

Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit në bashkëpunim me Ambasadën e Republikës së Kosovës në Tiranë mbajtën një takim letrar, ku i ftuar nderi ishte shkrimtari për fëmijë nga Kosova, Xhevat Sylja.

Ky takim bëri bashkë personalitete të librit shqip si dhe shumë shkrimtarë për fëmijë, të cilët çdo vit pasurojnë bibliotekën

e librit shqip me këtë lloj letërsie dhe u vu në pah se sa e rëndësishme është letërsia për fëmijë në rritjen dhe edukimin e brezave të rinj.

Xhevat Sylja, i lindur në Istog të Kosovës është një figurë kyçe e letërsisë për fëmijë në Kosovë dhe Shqipëri, i njohur për përkushtimin thelbësor ndaj artit të fëmijëve.

Disa nga veprat e tij për fëmijë janë: “Syri i pranverës”, “Hyrje në vjeshtë”, “Zilja e fëmijërisë”, “Mbreti nga Qerreti”, etj.

Gjithashtu ka botuar rreth gjashtë studime mbi letërsinë për fëmijë, tetë libra krijimtarie, një libër tregimesh dhe ka fituar çmime të rëndësishme si “Shkrimtar i vitit” në Tiranë dhe çmimin “Ymer Elshani” në Kosovë.





QKLL 2025

QERSHOR



AKTIVITETE TË QENDRËS KOMBËTARE TË LIBRIT DHE LEXIMIT

